REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM**

*Nr. Serial 000107*

**LEJE**

**PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR**

Nr. 07 Prot., datë 01/06/26

Miratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT LUMOR ISHËM

Nr.**10**, datë **14/05/2026**

| | |
|---|---|
| Emri i individit/subjektit: | **"ARDENO" SH.P.K** |
| I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): | **K11804001T** |
| Baseni Lumor: | **ISHËM** |
| Kodi i Trupit Ujor: | **GW35140103** |
| Qarku: | **TIRANË** |
| Bashkia/ Njësia administrative: | **TIRANË/ MËZEZ** |
| Koordinatat: | **X=480111 Y=4579428 Z=68 m** |
| Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: | **Qëllime të ndryshme (Sanitare)** |
| Prurja ekologjike | - |
| Sasia e ujit që jepet për përdorim | **$Q_{llog}$= 0.3 l/s** |
| Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) | **NUK KA** |
| Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer | **NUK KA** |
| Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: | **Pusetë shkarkimi – K.U.Z** |
| Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes) | **NUK KA** (ha) |
| Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka) | **SIPAS KUSHTEVE TË LEJES** |
| Periudha e vlefshmërisë | **5 VJET** |
| Hyrja në fuqi | **Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licensave dhe lejeve** |

**KRYETARI**

**ADRIAN GURRA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – KËSHILLI I BASENIT LUMOR – ISHËM

**Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor**

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e veta pajisjet për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organi përkatës që ka lëshuar lejen;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujor për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo vepre marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes;
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
11. Të lejojë rrjedhën ekologjike, sipas specifikimeve në leje;
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor në rast të një aksidenti, apo incidenti;
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme;
14. Të mos cënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur;
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet e tjera për veprimtarinë, të përcaktuara në ligjin për burimet ujore.